



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 28.1.2016, ora 14,30

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq dhe Emilija Redzeqi.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu, Shaip Muja.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.12.2015 dhe 27.1.2016,
3. Shqyrtimi i planit vjetor të punës në Komision,
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për monitorimin e Ligjit për Inspektionin bujqësor,
5. Te ndryshme ;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa verejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2015 dhe 27.1.2016

Procesverbali 18.12.2015 dhe ajo e 27.1.2016 u miratuan pa verejtje.

3. Raporti dhe Rekomandimet për monitorimin e Ligjit për Inspektionin bujqësor

Kryetari Fikrim Damka pasi që konstatoi se anëtarët e komisionit nuk kanë ndonjë shtesë në këtë dokument të punuar nga GP për çka falënderoi edhe një herë në emër të komisionit, i ofroi edhe një herë fjalën përfundimtare kryesuesit **Adem Salihaj** i cili përsëriti shtesën dhe që potencoi, në rekomandimin nr. 2 u shtua në fund fjalia “**apo deri sa të hartohet një ligj i veçantë për inspektionin.**”

Raporti u miratua nga komisioni unanimisht i cili i dërgohet mbledhjes plenare për miratim.

4. Shqyrtimi i planit vjetor

Fikrim Damka për planin e punës gjithashtu konstatoi se anëtarët e pranishëm nuk kanë plotësime, ndërkaq rreth monitorimeve të ligjeve , përveç Ligjit të Kadastrit në gjashtëmujorin e dytë do të monitorohet Ligji për ushqimin, me të cilin shtesë dhe shtesën e djeshme, **u miratua Plani i punës së Komisionit për këtë vit.**

Mbledhja përfundoi në orën 14,50.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka